

PJESË NGA KUSHTET E PËRGJITHSHME TË SIGURIMIT TË MALLRAVE GJATË TRANSPORTIT

1. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

- Kushtet e përgjithshme të kontratës për sigurimin e Mallrave gjatë Transportit, këtu më poshtë do të quhen shkurtimisht "Kushtet e Sigurimit".
- Shoqëria e Sigurimeve "ANSIG" SH.A. këtu më poshtë do të quhet "Siguruesi"
- Personi fizik ose juridik, interesi pasuror i të cilit do të mbulohet sipas këtyre kushteve të sigurimit, këtu më poshtë do të quhet "I Siguruari".

2. OBJEKTI I SIGURIMIT

2.1. Ky sigurim mbulon rreziqet ndaj të cilave janë të ekspozuara mallrat e siguruar gjatë udhëtimit, deri sa rreziqet specifike nuk janë përjashtuar shprehimisht. Format kryesore të mbulimit janë.

2.1.1. Mbulimi i rrezikut "C"

2.1.2. Mbulimi i rrezikut "B"

2.1.3. Mbulimi i rrezikut "A"

2.2. Mbulimi i rrezikut C Ky sigurim mbulon humbje, dëme dhe shpenzime të objektivit të siguruar të shkaktuara nga:

- Zjarri, eksplozioni
- Aksidente të mjeteve të transportit (përplasje, nxjerrje në breg, fundosje, ngecje në cektesë, përmblytje, dalje nga shinat).
- Shkarkimi i mallit në portin e fatkeqësisë.
- Sakrifica e avarisë së përgjithshme.
- Humbje ose dëmtim i mallit nga sakrifica e avarisë së përgjithshme.
- Shpenzimet për shpëtimin e ngarkesës.

2.3. Mbulimi i rrezikut B përveç mbulimeve të rrezikut C ky lloj sigurimi mbulon edhe:

- Tërmetin, shpërthimin vullkanik, rrufenë
- Rënia e ujit mbi bordin e anijes
- Dëmtime nga uji i detit ose i lumit
- Humbje totale e pakove të veçanta gjatë ngarkimit dhe shkarkimit

2.4. Mbulimi i rrezikut A

Nuk emërtohen rreziqet por mbuloen

- Të gjitha rreziqet e humbjeve ose dëmeve të shkaktuara nga çdo ngjarje e rastit e paparashikuar, aksidentale dhe e papritur.

3. PËRJASHTIMET

Ky sigurim përjashton dhe nuk mbulon humbje ose dëme të shkaktuara:

- Qëndrim i keq i paramenduar i të siguruarit;
- Rrjedhje e zakonshme, humbje të zakonshme në peshe dhe volum, konsum dhe amortizim i objektit të siguruar;
- Pamjaftueshmëria ose papërshtatshmëria e paketimit ose përgatitjes së objektit të siguruar;
- Vonesa edhe n.q.s. kjo është shkaktuar nga një rrezik i siguruar;
- Paaftësia paguese ose me karakter financiar të pronareve ose qeramarrësve të anijeve;
- Përdorimi i çdo lloj armatimi luftarak që mbeshtetet dhe shfrytëzohet reaksionet atomike dhe nukleare, shpërthimin bërthamor ose reaksione të tjera të ngjashme dhe/ose lëndet radioactive;
- Pavlefshmëria e anijes ose mjetit të transportit, papërshtatshmëria e anijes, kontenjerit, ose vinçit shkarkues apo ngarkues dhe rrethanave të tjera që kanë të bëjnë me kushtet specifike të ngarkimit, shkarkimit ose transportimit të mallrave;
- Lufta civile, revolucioni ose akte të tjera luftarake të ndërmarrura nga forca të ndryshme me pasojë dëmtimin, djegjen apo shkatërrimin e mallrave;
- Kapja mbajtja, arrestimi, kufizimi ose pengimi dhe çdo pasojë ose përpjekje që lind nga kjo;
- Mina, silura, bomba ose armë të tjera luftarake të lëna nga lufta;
- Punëtorët që kanë ndërprerë punën ose personat që marrin pjesë në trazirat e punës, turbullirat ose trazirat civile;
- Grevat, ndërprerjet e punës, trazirat ose turbullirat civile;
- Veprime terroriste me apo pa motive.

4. MJETET E TRANSPORTIT

4.1. **Transporti tokësor:** Pranohen të gjitha llojet e automjeteve të cilat përbushin kushtet per tu marre në sigurim dhe mbajnë dokumentet e domosdoshme për të zhvilluar transport automobilistik.

4.2. **Transport detar:** Pranohen të gjitha llojet e anijeve që plotësojnë "Klauzolat e Institutit të Klasifikimit të Londrës".

Për anijet me moshë mbi 15 vjet aplikohet prim shtesë si më poshtë por gjithmonë në vartësi të rrugës që do të kryej dhe mallit që transporton:

a-për anijet me moshë 16-25 vjet, primi rritet 0.10 %

b-për anijet me moshë 26-35 vjet, primi rritet 0.20%

4.3. **Transport ajror:** Pranohen kërkesat për sigurim Cargo për avion të licencuar nga shoqëritë ajrore të transportit.

5. PJESA E ZBRITSHME DHE FRANSHIZA (kufiri i papagueshëm)

5.1. Është pjesa për të cilën "I Siguruari" është vetë përgjegjës dhe që nuk paguhet nga Siguruesi në rast dëmi apo fatkeqësie.

5.2. Siguruesi është përgjegjës për gjithë humbjen ose dëmtimin n.q.s. kjo kalon franshizën e caktuar.

6. KONTRATA E SIGURIMIT

6.1. Marrja në sigurim e mallrave gjatë transportit bëhet mbi bazën e plotësimit të formularit tip (KËRKESA) në të cilën janë pasqyruar të gjitha të dhënat e nevojshme për marrjen në sigurim.

6.2. Kërkesa me shkrim për sigurim është dokument i rëndësishëm i "Të Siguruarit" dhe duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme.

6.3. Pas nënshkrimit të "Të Siguruarit" dhe lëshimit të Policës së Sigurimit ajo duhet të përmbajë këto të dhëna:

-Numrin e saj rendor dhe ruhet njëllor me Policën e sigurimit e mandatin e arkëtimit të primit;

-Përshkrimin e mallit, llojin e paketimit, peshën dhe numrin e pakove;

-Të dhëna në policën e ngarkesës ose dokumenteve të tjera shoqëruese të Mallit (bill of loading)

-Llojin e transportit (të dhëna të sakta zyrtare regjistrimi për mjetin)

-Vendin e ngarkimit, tranzitimit, dhe mbërritjes së mallit;

-Vlerën e mallit të siguruar;

-Kushtet e sigurimit të mallit;

7. PRIMI I SIGURIMIT

7.1. Primi i sigurimit paguhet në valutën përkatëse ose në Lekë kundrejt kursit ditor të valutës.

7.2. Kontrata e Sigurimit nuk hyn në fuqi para pagimit të primit, nëse nuk parashikohet ndryshe në kontratë.

8. PERIUDHA E SIGURIMIT

8.1. Ky sigurim fillon nga momenti që mallrat lëvizin drejt destinacionit ngarkimit, transportit dhe përfundon:

- Me dorzëimin tek pritësi ose në vendin e rënë dakort në kontratë;

- Për depozitim ndryshe nga kursi i zakonshëm i transportit;

- Për dhënie ose shpërndarje Cilado që të ndodhet e para;

9. VONESA

9.1. Ky sigurim do të mbetet në fuqi gjatë vonesave përtej kontrollit të Siguruesit;

9.2. Për çdo devijacion, shkarkim të detyruar, ringarkim ose ritransportim dhe gjatë çdo ndryshimi në avari detare që lindin nga e drejta që u lejohet pronarëve të anijeve ose qiramarrësëve në bazë të kontratës së transportit.

10. PËRCAKTIMI I VLERËS

10.1. **Vlera e Sigurimit është** vlera e mallrave në kohën dhe vendin e fillimit të udhëtimit me shpenzimet e transportit, primin e sigurimit dhe shpenzimet e tjera të kryera deri në destinacion e mallrave përfshirë 10% të fitimit të shpresuar.

10.2. **Vlera e zëvendësimit** është vlera e mallrave në destinacion në kohën e ndodhjes së dëmit në mungesë të dëshmise është vlera e siguruar.

10.3. **Shuma e siguruar** konsiston në limitin e të gjitha dëmshperblimeve për humbje ose dëme të shkaktuara nga një ose më shumë ngjarje.

10.4. **Sigurimi i pjesëshëm** nëqoftë se shumta e siguruar është më e ulët se vlera e zëvendësimit Siguruesi është përgjegjës vetëm për përpjestime të tilla të humbjes ose dëmit sa shumta e siguruar qëndron ndaj vlerës së zëvendësimit.

11. DETYRIMET E TË SIGURUARIT

11.1. **Paraqitja e të dhënave.** I siguruari është i detyruar të paraqesë vullnetarisht të gjitha rrethanat që përbejnë risk për Siguruesin.

11.2. I siguruari është i detyruar të japë të gjitha të dhënat që i kërkohen nga Siguruesi, përjashtuar ato që përmban Kërkesa.

11.3. Të gjitha të dhënat e kërkuara nga Siguruesi janë të detyrueshme të jepen e të domosdoshme për të Siguruarin.

12. NDRYSHIMET NE KURSIN E UDHËTIMIT TË MALLIT TË SIGURUAR

12.1. Pas nënshkrimit të kontratës së sigurimit, ndryshimi i drejtimit të udhëtimit do të shoqerohet me njoftim të menjëhershëm, kur palet bien dakort dhe prim shtese për ndryshimin e drejtimit.

12.2. Në rast se për shkak të rrethanave të ndryshme, kontrata e transportit përfundon në një port ose vend tjetër përtej kontrollit të të Siguruarit, atëhere ky sigurim do të përfundojë po të mos jepet njoftim i menjehershëm siguruarit dhe po të mos kërkohet vazhdimësia e mbuleses. Ky sigurim do të mbetet në fuqi kundrejt një primi shtese.

13. NJOFTIMI I NGJARJES SË SIGURIMIT

13.1. I Siguruari duhet të njoftojë brënda 48 orëve ngjarjen e sigurimit dhe duhet të marrë masa për ruajtjen e shpëtimin e mallrave për minimizimin e humbjeve.

14. SHPËRBLIMI I DËMIT

14.1 I Siguruari ka të drejtë të kërkojë nga Siguruesi dëmshperblimin brënda 24 muajve nga data e lindjes së kësaj të drejte.

14.2. I Siguruari i njeh Siguruesit të gjitha të drejtat kundrejt paleve të treta.

14.3. E drejta kundrejt paleve të treta bëhet efektive sapo që Siguruesi ka plotësuar detyrimin e tij të pagesës së dëmshperblimit.

14.4. Kur I Siguruari merr nga persona të tretë një pjesë të dëmshperblimit për dëmin e pësuar, Siguruesi detyrohet ti paguaj atij vetëm diferencën.

15. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

15.1. Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga kontrata e sigurimit ndërmjet Siguruesit dhe të Siguruarit zgjidhen nga Gjykata kompetente e vendit ku lidhet kontrata e sigurimit.

I SIGURUARI